



**TV DUKAGJINI**  
**Ermal PANDUARI**  
**Drejtor**  
**Prishtinë**

**Rasti Nr. 2019/77**  
**Ref:1910/1238/KPM/mf**

### VENDIM

#### **Lidhur me Rastin Nr. 2019/77- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TV Dukagjini (“Palë Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM 2017/07.
2. KPM me datë 19 shtator 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
3. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 23 shtator 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse është se gjatë transmetimit të emisionit “Debat PLUS” ka bërë reklamim me ekran të ndarë ka pasur sponsorizim të programit dhe vendosje te produkteve duke vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM 2017/07.
4. KPM pas të gjeturave nga monitorimi me datën 24 shtator 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale 2017/07. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

5. KPM me datën 30 shtator 2019, ka pranuar një përgjigje përmes të cilës Pala Përgjegjëse arsyetohet se po kalojnë në faza të vështira financiare dhe se largimi i sponsorizimit të emisioneve dhe vendosjes së produkteve do ta dëmtojnë rëndë pasi që Pala Përgjegjëse është një televizion privat dhe së të hyrat janë të vogla kështu që largimi i sponsorizimit të emisioneve dhe mos vendosja e reklamave në këto faza është e pa mundur.
6. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me fushatën zgjedhore prej datës 25 shtator 6 deri tetor 2019, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 8 tetor 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë transmetimit të emisionit “Debat Plus”, në të cilin trajton tema politike dhe çështje që janë në interes të publikut, ka pasur reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, ka pasur sponsorizim të programit duke vepruar në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 3, dhe vendosje të produkteve në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM 2017/07.
7. KPM bazuar në Raportin e monitorimit gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore ka gjetur se Pala Përgjegjëse, ka transmetuar spote politike të Subjekteve Politike si LDK, AAK-PSD, të cilat i ka identifikuar si spote me pagesë, mirëpo nuk i ka identifikuar se nga kush janë të paguara apo të sponsorizuara këto spote duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073.

### Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15, të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM2017/07, si dhe nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073.

Nenin 12 paragrafi 1 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

*“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t’ua pamundësojë shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”*

Nenin 14 paragrafi 3 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

*“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen.”*

Nenin 15 paragrafi 1 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

*“Vendosja e produkteve do të ndalohej.”*

9. Komisioni gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë emisionit “Debat Plus” në të cilin trajton tema politike dhe çështje që janë në interes të

